



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr. 624, datë 19.10.2023**

**PËR**

**CAKTIMIN NË POZICION TË GJYQTARIT TË EMËRUAR**

**Z. {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në pikën 3, të nenit 37, në pikën 3, të nenit 39 dhe në nenin 41, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në shkronjën “b”, të nenit 86, në pikën 1, të nenit 97 dhe në nenin 100, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në konsiderate të Vendimit të tij nr. 577, datë 12.10.2023, “Për emërimin gjyqtar të z. {...}”, bazuar në listën e pozicioneve të lira të shpallur me Vendimin e tij nr. 582, datë 18.10.2023, si dhe në renditjen e gjyqtarëve të emëruar në listën për “Klasifikimin e kandidatëve për magistratë, profili gjyqtar, që kanë mbaruar vitin e tretë në Shkollën e Magjistraturës, 2022-2023”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Gjyqtari i emëruar z. {...} caktohet në pozicion në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
2. Ushtrimi i funksionit të gjyqtarit fillon nga data e betimit.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike të depozituar zyrtarisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**